



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 29/18
Prishtinë, më 18.7.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Jelena Bontiq, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Blerim Kuqi dhe Enver Hoti.

Munguan: Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Fikrim Damka dhe Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Fatmir Gashi – Zv.Ministër i Financave, Milaim Aliu nga Ministria e Financave, Ymer Havolli – Kryesues i FKPK-së, Hajdar Korbi nga FKPK, Valdrin Kasumaj nga FKPK, Adrian Zalli – Drejtor i FKPK-së, Afërdita Maliqi, Kryetare e Bordit të RTK-së, Mufail Limani – Zv.Drejtor i Përgjithshëm, Adelina Valla – Udhëheqëse e Financave në RTK.

Pjesëmarrës tjerë: Valbona Bytyqi – Gazetare, Albulena Nuha – Gazetare, Nora Kokaj – nga Ambasada Britanike, Blerina Krasniqi – nga KPI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe teknologjisë dhe amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike dhe amendamenteve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe amendamenteve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-022 për Projektligjin për Ndërmarrje Sociale dhe amendamenteve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale;
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017;
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozojë që në mungesë të Kryesueses së KQZ-së, pika 10 të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht, me ndryshime. Pika e 10 shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe teknologjisë dhe amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Kryetari: Projektligji në fjalë është proceduar nga Ministria e Arsimit, ndonëse e kemi një Ministri për Inovacion. Për mua është e pakuptueshme se si mundet Ministria e Arsimit të hartojë një draft ligj për inovacion, kur e kemi ministrinë respektive. Ky projektligj përmban një kosto buxhetore prej 9 milion euro, që nuk është paraparë në Buxhetin e Kosovës për vitin 2018.

Fatmir Gashi: Departamenti i Buxhetit të MF me 4 dhjetor 2017, ka pranuar projektligjin dhe ka dhënë vlerësimet e kostos shtesë buxhetore që krijon projektligji. Në ndërkohë kanë ndodhur ndryshimet strukturore në qeveri dhe është krijuar Ministria e Inovacionit. Si rezultat, buxheti për zbatimin e këtij ligji nuk është paraparë në Ministrinë e Arsimit, por është paraparë në Ministrinë e Inovacionit. Mendojë që procesi duhet të kordinohet dhe ligji duhet të zbatohet Ministrinë e Inovacionit dhe si rezultat buxhet është paraparë edhe në vitin 2018, por edhe në dy vitet pasuese. Për këtë projektligj, nuk ka mjetet të planifikuara në Ministrinë e Arsimit as për vitin 2018, por edhe as për vitet 2019-2020.

Safete Hadërgjonaj: Theksoi se ishte dashur Qeveria të ketë parasysh ndryshimin e strukturës organizative të saj dhe mos me lejue që projektligji me u procedue në këtë formë në Kuvend. Po më intereson të dijë se a është ftuar Ministria e Financave në komisionin funksional për të dhënë sqarime lidhur me koston buxhetore? Komisioni funksional ishte dashur të analizojë projektligjin dhe të propozojë ndryshime ku përgjegjësitë që bien në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ti kalojnë kësaj ministrie, ndërsa ato që janë të Ministrisë së Arsimit, ti mbesin asaj ministrie. Përndryshe është shqetësuese nëse miratohet ky ligj në këtë formë me këtë kosot të lartë buxhetore dhe me kompetenca të përziera. Kjo jo vetëm që do të ndikojë në mos zbatueshmërinë e ligjit, por ne do të marrim edhe vërejtje nga institucionet ndërkombëtare.

Enver Hoti: Kjo çështje ishte dashur të diskutohet në Qeveri. Unë mendojë që ne nuk mund të pengojmë këtë projektligj në këtë komision. Ai duhet të procedohet në Kuvend dhe është mundësia e sqarimeve dhe kjo çështje duhet të rregullohet dhe harmonizohet nëpërmes ministrive përkatëse.

Blerim Kuçi: Projektligji është në fazën e leximit të dytë. Komisioni ynë është përgjegjës me shikue vetëm anën e implikimeve financiare. Ishte dashur që në lexim të parë të diskutohet kjo çështje.

Safete Hadërgjonaj: Meqë projektligji ka përzierje kompetencash, do të ishte mënyra më e mirë që ministria sponsorizues të tërheq projektligjin dhe të rregullohet materia dhe të procedohet përsëri në Kuvend.

Blerim Kuçi: Ne duhet kërkuar sqarime shtesë, para se me marrë ndonjë vendim për refuzimin e këtij projektligji, përfshirë edhe çështjen e implikimeve buxhetore për zbatimin e ligjit.

Kryetari: propozojë që Komisioni për Buxhet dhe Financa ti rekomandojë Kuvendit që Projektligji përmban implikime buxhetore shtesë që nuk është pjesë e Buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018 dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2019-2021. Buxheti për inoacione është i ndarë në kuadër të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, dhe rekomandohet që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, t'i koordinojë aktivitetet dhe buxhetin me Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, për zbatimin e detyrimeve që dalin nga ky ligj.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me gjashtë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-049 për Inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë, përmban implikime buxhetore shtesë që nuk është pjesë e Buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018 dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2019-2021.
2. Buxheti për inoacione është i ndarë në kuadër të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, dhe rekomandohet që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, t'i koordinojë aktivitetet dhe buxhetin me Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, për zbatimin e detyrimeve që dalin nga ky ligj.
3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi për Projektligjin nr.06/L-049 për Inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike dhe amendamenteve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari: Në bazë të opinionit të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike, dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe amendamenteve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari: projektligji në fjalë nga Ministria e Financave është vlerësuar se përmban një kosto buxhetore shtesë.

Fatmir Gashi: Në bazë të vlerësimeve nga Departamenti i Buxhetit të MF, për vitin 2019-2021, 11,810,000 euro është kostoja buxhetore për zbatimin e këtij ligji. Nëse ky ligj miratohet, duhet bërë ndryshimet në KASH, për të paraparë koston shtesë buxhetore.

Kryetari: Meqë për vitin 2018, kostoja buxhetore është e përballueshme, të rekomandojmë që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, në planifikimet e ardhshme buxhetore për vitin 2019-2021, duhet të planifikojnë koston buxhetore për zbatimin e Ligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me gjashtë vota Për, asnjë Kundër dhe një Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, në planifikimet e ardhshme buxhetore për vitin 2019-2021, duhet të planifikojnë koston buxhetore për zbatimin e Ligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për Projektligjin nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Administrate Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetari: Në bazë të opinionit të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e Komisionit për Administrate Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale dhe amendamenteve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale

Kryetari: Në bazë të opinionit të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale dhe amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017

Ymer Havolli: Në vitin 2017, Fondi ka përmbyllur me një kthim të mjeteve në investime në vlerë nominale prej 102.6 milion euro. Kthim po ashtu edhe në çmim të njësisë me 6.5 %. Bordi Drejtues gjatë vitit 2017 ka investuar mesatarisht 93% e mjeteve nën menaxhim, ndërsa ekspozimi në Kosovë është rreth 10%. Investimet në tregjet globale financiare kanë kontribuar 97.9% në fitimin bruto, ndërsa nga investimet në Kosovë kanë kontribuar me 2.1%. Bordi ka angazhuar rreth 365 milion euro tek fondet e angazhuara, ndërsa i ka tërhequr 283 milion për ti alokuar në pozicione tjera, varësisht nga lëvizjet në tregje. Përveç në tregje globale, FKPK, plasojë 125 milion euro në Kosovë.

Në aspektin operacional kishte rritje për 4.5% ose 159.8 milion euro dhe numrit të kontribuesve aktiv rreth 12.8% apo 352,849 kontribues. Deri në fund të vitit mjetet nën menaxhim të FKPK-së ishin ekuivalent me 26% të GDP-së. Themelimi i Njësisë së Investimeve ka kontribuar në procesin e investimeve dhe kthimit pozitiv të mjeteve. Menaxhmenti vazhdojë digjitalizimin e proceseve të brendshme, përmes përmirësimit të regjistrimit të e-trustit dhe përmirësimit të komunikimit elektronik me kontribuesit. Detyrë e re për këtë vit është realizimi i ndryshimit ligjor që kërkon kthimin në ATK të mjeteve të paalokuara nga FKPK-ja, duke kthyer 7.4 milion euro kontribute dhe 2.6 milion euro investime duke marrë si datë fund shtatorin e vitit 2017. Mjetet nën menaxhim po shkojnë në 1.7 miliard euro, ndërsa llogaritë e kontribuesve mbi 600,000.

Kryetari: Fillimisht duhet falendaruar për mënyrën dhe informacionit që përmban raporti i Fondit, e që do të donim të kishim në këtë formë edhe nga agjencionet tjera. Shifet viti 2017 ka shënuar një performancë të mirë të menaxhimit dhe kthimit të mjeteve të investuara. Çmimi i aksionit në fund të vitit 1.4648 është mjaftë i mirë, siç është i mirë edhe numri i kontribuesve aktivë gjatë vitit.

Kam dy çështje. E para, ne kemi pasur një komunikim me Bordin Drejtues dhe kemi rekomanduar për nivelizimin e pagave në mes menaxhmentit të FKPK-së me BQK-në, dhe kam pranuar një shkresë nga Bordi se ky nivelizim ka ndodhur. Për çështje protokollare dhe informimit të seancës ju lutem që edhe në këtë mbledhje, të konfirmoni edhe tani se ky nivelizim ka ndodhur. E dyta, është një çështje teknike, në faqen 15 të raportit të auditimit, e shoh një tendencë të rritjes së investimeve në instrumentet e borxhit kryesisht spekulative dhe mesatare të ulët në krahasim me vitin paraprak. Cilat janë arsytet prapa kësaj rënie? A ka rritje të rrezikut në investime dhe nëse vazhdon një gjendje e tillë, çfarë pritje kemi në vitet e ardhshme? Çështja e fundit është të dijë, si është gjendja e fundit këto gjashtë muajt e këtij vitit, a është çmimi i njëjtë i aksionit 1.4648% apo ka rënie? A ka hapësirë për rrezik apo alarm për rënie të kthimit të investimit të mjeteve?

Ymer Havolli: Theksoi se FKPK-së ka krijuar një komision ad hoc prej tre anëtarëve, i cili ka bërë një rishqyrtim të pagave sipas kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për menaxhmentin e Fondit. Shkresën që kemi dërguar Kryetarit të Komisionit është vendim i Bordit Drejtues që është bërë nivelizimi i pagave të menaxhimit të Fondit, me nivelin e pagave të menaxhmentit të BQK-së. Kjo ndryshim do të zbatohet me buxhetin e vitit 2019.

Adrian Zalli: Sa i përket çmimit të aksioneve, ka lëvizje dhe kjo është si rezultat i rënies së rejtingut, por kjo nuk do të thotë që është rrezik i mënjëhershëm. Kemi rastin edhe të Thesarit të Kosovës që nuk ka kurfarë rejtingu, por ne i investojmë mjetet pasiqë konsiderohen më të sigurt. Sa i përket çmimit të njësisë, fundi i vitit ka përfunduar me 1.464, kurse dje ishte 1.467. Gjatë vitit kemi pasur periudha të ndryshimit të çmimeve të aksioneve, si rezultat i ndryshimeve në tregjet globale dhe ndryshimeve dhe ndikimeve të politikës në botë. Aktualisht jemi dikun 7 milion euro plus. Aktualisht nuk ka shenja të rrezikut të rënies së mjeteve të investuara. Bordi ka mbajtur disa mbledhje, përfshirë edhe mbledhje të jashtëzakonshme dhe është vlerësuar se ne jemi investitorë afatgjatë dhe duhet mbajtur këtë strategji që është edhe misioni i Fondit.

Safete Hadërgjonaj: Ne gjithëherë kemi pranuar raporte të detalizuara nga ky institucion, për çfarë duhet përgëzuar dhe urojë që të vazhdohet kjo praktikë edhe më tutje. Megjithatë, e kam një vëretje të shkronjat e vogëla për lexim. Më gëzon fakti që deri më tani ka pasur stabilitet në tregjet financiare dhe ka pasur kthim pozitiv të këtyre mjeteve. Investimet janë bërë në 40 shtete, përfshirë edhe në Afrikë, Azi dhe si nuk mundet të investohen më shumë këto mjete në Kosovë? Në raport kam parë ku shkruhet se ne po investojmë në të ardhmen. Si po investojmë në të ardhmen me këto mjete, ku gjitha mjetet çarkullojnë në tregjet ndërkombëtare?!

Më intereson të dijë si është e rregulluar kjo çështja e investimeve të mjeteve në shtetet fqinje? A i investojnë të gjitha mjetet në tregjet ndërkombëtare apo kanë një përqindje më të madhe të mjeteve që çarkullojnë në tregjet e tyre të brendshme, sepse në këto rrethana ku miliona euro të mjeteve të privatizimit dhe të kursimeve pensionale janë jashtë vendit, atëherë në një farë mënyre ne po kontribuojmë në zhvillimin ekonomik të vendeve tjera, e nuk po kontribuojmë në zhvillimin e vendit tonë. Çfarë mund të bëjmë në këtë drejtim, a është nevoja për të ndryshuar legjislacionin për të mundësuar investim më të madh të mjeteve në Kosovë.

Nga raporti po e shoh se mesatarja e shpenzimeve të stafit është 1,919 euro, kurse mesatarja e shpenzimeve të Bordit Drejtues është 1,927 euro, edhe përkundër faktit ku të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues e kanë edhe një punë tjetër.

Ymer Havolli: Çështja e investimeve në Kosovë është në përputhje me ligjin në fuqi. Por, po iu njoftojmë se që nga viti 2010 kur kanë filluar me u emitue fletëobligacionet nga shteti i Kosovës, ne kemi 500 milion euro të investuara në Kosovë. Depërtimi në tregjet financiare është një mrekulli për Kosovën. Asnjë shtet që nuk është anëtar i BE-së dhe që ka statusin e Kosovës nuk mund të marrë pjesë në tregjet financiare, pasi që nuk e ka rejtingun e pranuar. Këto janë kursime të kontribuesve dhe nuk janë para publike. Ne kemi dalur si Fondi më i mirë në krahasim me të gjitha fondet e shteteve tjera të cilat kanë pasur tranzicion në këto kushte.

Blerim Kuçi: Për neve më rëndësi është çështja e riskut. Sa është i shpejtë reagimi në rast të parqitjes së gjendjes alarmante siç ka ndodhur në vitin 2008, kur ka pasur rënie të madhe të mjeteve të investuara? Po ashtu më intereson për trendet e gjashtëmujori të këtij viti? A kemi nevojë për reagim apo marrjen e ndonjë vendimi për mjetet e investuara, që mos të përfundojë kjo çështje vetëm përmes formës së raportimit njëherë në vit?

Adrian Zalli: Në vitin 2008 nuk kemi pasur Bord në detyrë dhe nuk kemi mundur të reagojmë. Ne kemi Departamentin e Investimeve me njerëz profesional që bëjnë analiza dhe i shikojnë lëvizjet e tregjeve në

baza ditore. Këto informata përcillen tek menaxhmenti dhe Bordi në baza ditore, javore dhe mujore. Parashikimet e sakta për tregjet financiare në botë është vështirë të bëhen, për shkak edhe të ndryshimeve të situatave politike në botë. Në këto situata, Bordi vendos për kthimin e mjeteve, qoftë edhe në BQK, me çëllim të ruatjes së sigurisë së tyre.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të punës të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017

Afërdita Maliqi: Theksoi se Raporti përmban të dhëna për të hyrat dhe shpenzimet e RTK 1, RTK 2, RTK 3, RTK 4, Radio Kosova, Radio Bluesky si dhe mediat online. Buxheti i RTK-së për vitin 2017 ishte 13,300,000 euro, i ndarë sipas kategorive: paga 6,261,000 euro, mëditje, kontribute, kontrata kolektive 1,326,366 euro, investime kapitale 1,560,000 euro, shpenzime komunale 325,000 euro dhe mallra dhe shërbime 3,827,634 euro. RTK në periudhën raportuese ka shpenzuar 13,670,965 euro, prej të cilave për paga 6,261,040 euro apo 100%, mëditje, kontribute, kontrata kolektive 1,183,325 euro apo 89.22%, investime kapitale 794,132 euro apo 50.91%, shpenzime komunale 264,918 euro 81.51% dhe mallra dhe shërbime 4,564,550 euro apo 122.95 %. Kategoria e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve është ngarkuar në shumë prej 864,354 euro si pasojë e mos rimbursimit të TVSH-së nga ATK. Për shkak të specifikave të punës, në mallra dhe shërbime janë përfshirë shpenzime për programe të ndryshme të realizuara nga RTK dhe shpenzimet tjera të kësaj natyre.

RTK është audituar nga Auditori i Jashtëm i Pavarur dhe vlenë të përmendet se opinioni i auditorit është i pakualifikuar. Sfidat që është përballur RTK është çështja e financimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë, çështja e pazgjidhur e pronës, digjitalizimi i ngecur në mungesë të buxhetit.

Kryetari: Theksoi se i mirëkutojë kërkesat për financim të qëndrueshëm të televizionit publik, por kam përshtypjen se para se të ipet mbështetje e tillë, do duhet të na jepni disa shembuj të menaxhimit të mirë të parasë publike. Në vazhdim kam disa pyetje për sqarim. E para ka të bëjë përzgjedhjen e auditorit, ndonëse secili auditor i licencuar ka të drejtë të kryejë auditimi, por për organizatat e mëdha, siç është edhe RTK, iu shkon për shtati të zgjidhet njëra prej kompanive më kredibile e auditorëve. Një auditor lokal që bënë auditimin e mbi 13 milion euro, nuk më lënë përshtypje të mirë dhe në fakt më lënë përshtypjen edhe ndoshta të tendencës së fshehjes së këtij raporti. Do ta konsultojmë hapësirën ligjore dhe do të bëjë një pyetje tek Auditori Gjeneral për të kërkuar auditimin e RTK-së për raportin financiar 2017.

Më intereson të dijë sa është numri i punëtorëve në total? Sa është numri i punëtorëve me kontratë mbi vepër? Sipas analizave të bëra nga stafi mbështetës nga viti paraprak janë shtuar dikun rreth 42 punëtor. Si është e mundur që me 784 puntëtor keni kaq shumë produksione të jashtme, që do të mund të kryeshin prej stafit aktual që keni? Provizioni i TVSH-së që ka ndikuar në tejkalimin e mallrave dhe shërbimeve, çfarë është?

Sa i përket udhëtimeve jashtë vendit, arsytimi është kryesisht për përcjelljen e delegacioneve jashtë vendit. Në anën tjetër thuhet se 255,000 euro shpenzohen për korrespondentët tuaj në Evropë. Pse duhet të dërgoni ekipe përcjellëse në vizita të delegacioneve tona dhe si rrjedhojë të bëni shpenzime buxhetore, kur i keni korrespondentët në ato vende? Në investimet kapitale, ju keni futur edhe amortizimet, sa është vlera e këtyre shpenzimeve të amortizimit?

Bleim Kuçi: Sa i përket shpenzimet për mallra dhe shërbime, në raport është pasqyruar se ka 22% tejkalim të planifimit? Raporti i auditorit të jashtëm është i pakualifikuar, ndërsa ju keni bërë tejkalim të shpenzimeve. Do të ishte është me interes të na jepni sqarime për tejkalimin e shpenzimeve nga ato të planifikuara?

Arbërie Nagavci: Pyeti sa është vlera e borxhit që RTK ka ndaj palëve të treta, sepse nuk është e shënuar në raport? Po ashtu edhe unë po pres një përgjigje për numrin e saktë të punëtorëve (të atyre me kontratë të rregullt dhe të atyre me kontratë mbi vepër)? Po ashtu është me interes të na jepni sqarime lidhur me shpenzimet e RTK-së me palët e jashtme për disa programe apo emisione të caktuara, sepse në raport janë disa shpenzime për disa emisione që janë paraqitur në të njëjtën kategori. Ndërsa, sa i përket shpenzimeve të udhëtimit brenda dhe jashtë vendit e keni shënuar shumën totale, por nuk i keni specifikuar llojin e shpenzimeve, a janë akomodim, ushqim, mëditje apo shpenzimet e udhëtimit?

Adelina Valla: Sa i përket angazhimit të auditorit të jashtëm është përgjegjësi e zyrës së prokurimit dhe nuk jam e autorizuar të flas. Sa i përket numrit të punëtorëve, në raportin e auditimit është përmendur numri prej 784 (duke përfshirë numrin e punëtorëve të rregull prej 769, menaxhmenti i lartë 6 dhe numri i Bordit 9). Sa i punëtorëve me kontratë mbi vepër tani nuk e kam një numër të saktë, sepse janë të punësuar që lëvizin.

Lumri Abdixhiku: Pyeti Kryetarin e Bordit të RTK-së, a keni trajtuar numrin e punëtorëve si Bord, nëse po sa janë punëtorë me kontratë të rregullt dhe sa me kontratë mbi vepër?

Afërdita Maliqi: U përgjigj se në çdo mbledhje të Bordit është trajtuar edhe çështja e numrit të punëtorëve. Të punësuar me kontratë mbi vepër janë rreth 200, përfshirë edhe të angazhuarit në Kanalin RTK 2, një pjesë janë artistë, analistë.

Arbërie Nagavci: Lidhur me punëtorët me kontratë mbi vepër që përmendet rreth 200, a ka raste kur të njëjtit persona kanë disa kontrata, apo janë 200 kontrata të ndryshme për persona të ndryshëm?

Afërdita Maliqi: Sqaroj se tek RTK 2, sillet pothuasje të njëjtit persona me kontratë mbi vepër. Por tek artistat për shembull kemi persona të ndryshëm, varësisht prej programit që angazhohen. Sa i produsioneve të jashtme, në bazë të ligjit jemi të obliguar që 20% e programit total të kemi nga jashtë.

Lumri Abdixhiku: Sa i përket produksioneve të jashtme, hapësirën e marketingut dhe të hyrat nga reklamat gjatë emisioneve të tyre, a i gjenerojnë në emër të vetin këto produksione apo ato janë të hyra të RTK-së.

Adelina Valla: Sqaroi se për hapësirën e reklamave sipas kontratës mjetet i shkojnë RTK-së.

Safete Hadërgjonaj: Pyeti ku i keni marrë 22% e mjeteve për me i pague shpenzimet për mallra dhe shërbime të tejkaluara?

Adelina Valla: Sqaroi se 22% në mallra dhe shërbime është vlera e TVSH-së që kemi qenë të obliguar ta provizionojmë, si rezultat i rekomandimeve të auditorit nga viti paraprak, për shkak të ndryshimit të Ligjit të TVSH-së, dhe mjetet janë si rezultat i kursimeve në investimet kapitale. Provizionimi i kërkesës së TVSH-së është vetëm shpenzim fiktiv i paraqitur si i tillë në raport, ndërsa pagesa nuk është bërë.

Mufail Limani: Lidhur me udhëtimet jashtë vendimit, sqaroi se është problem me menaxhime në mënyrë të saktë, pasi që dalin lëvizje të paplanifikuara të vizitave të delegacioneve të ndryshme. Ne kemi disa korrespondentë në disa shtetet, si në Bruksel, që janë mjaftë aktivë në përcjelljen dhe informimin në baza

ditore. Por në raste të veçanta për shkak të kërkesave nga institucionet e Kosovës dhe nevojës për mbulim dhe informim, i dërgojmë përforcime të ekipeve që i shoqërojnë ato.

Kryetari: Kërkojë nga Kryetarja e Bordit të RTK-së, që ti dërgojë Komisionit në mënyrë konfidenciale, listën e punëtorëve dhe pagat për të punësuarit në RTK.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me tre vota Për, dy Kundër dhe një Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku